



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:066534

Datë: 17.10.2019

Numri i dokumentit: 00585796

P.nr. 501/2018

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEGA NË SUHAREKË, Gjyqtari Qemail Suka, me pjesëmarrjen e Sek. Juridike Vjollca Haziraj, në lëndën penale sipas P.Th. nga Prizreni, aktakuzës PP.II.nr.2648-8/18 të datës 09.11.2018, ndaj të pandehurës A. K. nga fshati B. Komuna Suhareke, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 nen par. 4.1 dhe veprën penale kanosja nga neni 185 par. 2 i Kodit Penal, në prezencë të prokurorit të PTH-së, nga Prizreni Shpend Binaj dhe të akuzuarit, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, të mbajtur me dt.10.10.2019, mori, publikisht shpalli dhe me date 17.10.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara A. K., nga i ati J., e ëma A., e lindur me dt. 29.06.1983 nga fsh. B., e martuar, ka të kryer tri vite të shkollës fillore, me numër personal, e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare shtetase e Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

- I. Sepse me dt. 21.09.2018 rreth orës 13;30 minuta, në fsh. B. Komuna Suharekë, me qellim që të shkaktoj lëndime trupore të dëmtuarit të mitur E. K., në atë mënyrë që pasi fillimisht ishin zënë mes vete i dëmtuari dhe djali i të pandehurës, e pandehura kur i ka parë fëmijët duke u zënë, shkon me nxitim dhe e sulmon fizikisht të dëmtuarin duke e goditur me një gyp të plastikës dhe me shuplaka në fytyrë dhe në pjesën e ndryshme të trupit, deri sa edhe ishte alivanosur i dëmtuari, me ç rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore, lëndime këto të konstatuara nga eksperti mjekoligjor Dr. V. H..

Me këtë ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 nen par. 4.1 i Kodit Penal.

- II. Sepse me datë 21.09.2018 rreth orës 13.30 në fsh. B. komuna Suharekë, me dashje e kanosë të dëmtuarin të mitur E. K., në atë mënyrë që pasi fillimisht e sulmon fizikisht dhe i shkakton lëndime trupore, me pas e kanos me fjalët

“ka me të vra, në dhe kam me të shti “ me të cilat veprime tek i dëmtuarit shkaktën ankth, frikë, dhe pasiguri për jetën e tij.

Me këto veprime ka kryer veprën penale kanosja nga neni 185 par. 2 të KP-së

Andaj gjykata në kuptim të nenit 41, 51, 52, 73, 74 të KP-së, dhe 359 par. 1 dhe 2 dhe neni 365 KPK-së, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Sipas dispozitivit nën I. të aktakuzës, duke i a caktuar dënimin me burgim prej 4 (katër) muajve burgim, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin e verifikimit prej një viti e akuzuara nuk kryen vepra tjera penale.

Sipas dispozitivit nën II. të aktakuzës, duke i a caktuar dënimin me burgim prej 2 (dy) muajve burgim, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin e verifikimit prej një viti e akuzuara nuk kryen vepra tjera penale.

Gjykata konform nenit 80 të KP-së, i shqipton:

Dënim unik-dënim me kusht

Duke i a caktuar dënimin prej 5 muajve burgim i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse në afatin e verifikimit prej një viti e akuzuara nuk kryen vepra tjera penale.

E akuzuara lirohet prej shpenzimeve të procedurës konform nenit 453 par. 4 të KPP-së.

A r s y e t i m

PTH-e me aktakuze, **PP.II.nr.2648-8/18 të datës 09.11.2018**, ndaj të pandehurës A. K. nga fshati B. Komuna Suhareke, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par. 3 nën par. 4.1, dhe veprën penale kanosja nga neni 185 par. 2 të Kodit Penal, të cilin gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor e ka përfaqësuar PSH nga Prizreni Shpend Binaj, i cili në tërësi ngel pranë të dhënave si në aktakuze, që e akuzuara të shpallet fajtorë dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata në shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e të akuzuarës ka vërtetuar këtë gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i të akuzuarës e cila në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 të KPP-së në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë prove të pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se e akuzuara, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajit nga ana e të akuzuarës, është bere vullnetarisht në shqyrtimin gjyqësor pranimi është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza, të cilat gjinden në shkresat e lëndës si dhe provat materiale të paraqitura ndaj të akuzuarës nga ana e PTH-së në Prizren.

Gjykata po ashtu në tërësi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë në shqyrtimin gjyqësor nga ana e të akuzuarës, është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248 të KPP-së, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsyet dhe kushtet për hedhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Gjykata ne shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e te akuzuarës ka vërtetuar këtë gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i te akuzuarës e cila ne shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 te KPP-së ne shkresat e lendes nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se e akuzuara, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, pranimi i fajit nga ana e te akuzuarës, është bere vullnetarisht ne shqyrtimin gjyqësor pranimi është mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, te cilat gjinden ne shkresat e lendes si dhe provat materiale te paraqitura ndaj te akuzuarës nga ana e PTH-së ne Prizren.

Gjykata po ashtu ne tërësi ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë ne shqyrtimin gjyqësor nga ana e te akuzuarës, është bërë ne pajtim me dispozitat e nenit 248 te KPP-së, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsyet dhe kushtet për hedhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Gjykata gjate marrjes se vendimit mbi dënimin ka vlerësuar te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP-ës, te cilat ndikojnë ne lartësinë e dënimit.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për baze se e akuzuara ka pasur qëndrim korrekt ndaj gjykatës, ka pranuar fajësinë ne mënyrë vullnetare, është penduar për veprat e kryera, është hera e pare qe bie ndesh me Ligjin, kurse rrethana posaqërishtë rënduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori ne kuptim te nenit 463 te KPP-së. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u mori ne kuptim te nenit 452 par, 1 te KPP-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA NË SUHAREKË

Gj y q t a r i
Qemail Suka

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtine, përmes kësaj Gjykate.